



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:143076

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06228283

C.nr.3744/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.Sh. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson H.S. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson zyrtarja ligjore A.A. me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilar dhe tri pagave përcjellëse, vlera e kontestit 2,135.89 €, jashtë seance, me datë 30.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses N.Sh. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të *“Detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit, me seli në Prizren, që në emër të dy pagave mujore të fundit në shumë prej 914.36 €, në emër të përcjelljes në pension, si dhe në emër të shpërblimit jubilar tri (3) paga mujore në shumë prej 1,281.54 €, përkatësisht shumën prej 2,135.89 €, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e paraqitjes së padisë e deri në në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm”*.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja N.Sh. nga Prizreni, me datën 14.07.2022, përmes të autorizuarit të saj H.S. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me objekt të padisë kompensimi i pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë. Në padi, paditësi ka theksuar se paditësja me aktvendimin e datës 27.08.2019, e ka përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionit, ndërsa e paditura sipas kërkesës së paditëses e ka paguar vetëm një pagë në lartësi prej 427.18 euro, ndërsa nuk e ka bërë kompensimin e dy pagave tjera për përcjelljen në pension, e po ashtu nuk e ka bërë kompensimin e tri pagave jubilarë, në emër të shpërblimit jubilar. Tutje ka shtuar se e paditura nuk e ka respektuar Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive e cila ka hyrë në fuqi me datë

01.01.2015, ku në nenin 82 tv saj është paraparë kompensimi i tri pagave si shpërblim jubilar dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovon në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit, përmes zyrtares ligjore të saj, në përgjigjen në padi, të dorëzuar në gjykatë me datën 16.08.2024, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. E njëjta ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë, Shkencë, Teknologjisë dhe Inovacionit nr. 01B/488, të datës 21.11.2022, për Shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadija e paditëses është e pa bazuar. Po ashtu ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtar i sindikatës. Sipas saj, të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: aktvendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës me numër 01-118-124528, të datës 27.08.2019; Vendimin e datës 19.09.2019, për Njohjen e të Drejtës së Pensionit Kontribut pagues të Moshës; Përgjigjen nga e paditura me numër 01-120-14287/01, të datës 26.02.2020; Listat e pagave me numër EM00052112, në emër të këtui paditëses; përgjigjen me numër 01-117-164695/01, të datës 31.12.2019.

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 399, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja tek e paditura ka qenë në marrëdhënie pune, ndërsa e njëjta është pensionuar me datë 30.08.2019 dhe se të njëjtës i është lejuar kompensimi i një pagese në shumë të një page mujore, fakt që vërtetohet me aktvendimin me nr. 01-118-124528, të datës 27.08.2019, për përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet. Paditësja me padinë e saj ka kërkuar kompensimin e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, si dhe kompensimin e tri pagave jubilarë. Gjykata bazuar në të lartcekurat ka

vërtetuar faktin se paditësja N.Sh. ka punuar pranë të paditurës në pozitën Referente në Zyrën e Pritjes, në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike pranë të Paditurës Komuna e Prizrenit, deri më datë 30.08.2019, kur edhe është pensionuar, i cili fakt vërtetohet nga aktvendimin me nr. 01-118-124528, të datës 27.08.2019, e bazuar në këtë fakt gjykata konstaton se paditësja moshën e pensionimit tek e paditura e ka arritur me datë 27.08.2019, kurse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, e cila aplikohet për periudhën kohore (01.01.2015-31.12.2017), nuk ka zbatueshmëri në vitin 2019, përkatësisht në kohën e pensionimit të këtu paditësit. Po ashtu gjykata e vlerësoi si të pabazuar edhe kërkesën e paditëses që ti kompensohen tri paga jubilarë, pasi bazuar në nenin 52, par.1. pika 1.3, të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të datës 18.03.2014, është përcaktuar se *“I punësuari ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.3. për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave mujore të tij.”*, ndërsa bazuar në provat e lartcekura, përkatësisht në Listat e Pagave me numër EM00052112, në emër të këtu paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësja gjithsej i ka 39 vite përvojë pune, e bazuar në përllogaritjen e gjykatës, paditësja 30 vite të përvojës së punës i ka arritur në vitin 2010, në kohën kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, nuk ka qenë në fuqi. Po ashtu duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik, për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023, në pikë II përcaktohet që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, aplikohet për periudhën kohore nga data 01.01.2015 - 31.12.2017. Në bazë të lartcekurave gjykata konstaton se paditësja në periudhën për të cilën aplikohet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, (01.01.2015-31.12.2017) nuk ka arritur moshën e pensionimit, e po ashtu kjo marrëveshje nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësja ka mbushur 30 vite të përvojës së punës dhe për këtë arsye kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pabazuar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 dhe nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3744/2024, 30.09.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.

Numri i lëndës: 2022:143076
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06228283